



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 20/14 Prot.

Pogradec, më 26.02.2026

VENDIM

NR. 23 , DATË 25.02.2026

**“PËR MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË DHE TË NIVELIT TË QIRASË MESATARE NË TREGUN E LIRË”**

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.05.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 38 të Ligjit 22/2018 “Për Strehimin social” i ndryshuar, në pika 4 e VKM Nr. 362 datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qerasë në tregun e lirë nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKM Nr.459 datë 03.07.2019 Mbi rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qerasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimit dhe bashkëpunimit ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, VKB mbi miratimin “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026”, Udhëzimit Nr. 31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, Ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ; paraqesim për miratim vlerën maksimale të subvencionimit të qerasë dhe vlerën mesatare të qerasë në tregun e lirë për programin “Subvencionimi i Qerasë” që zbatohet nga Bashkia Pogradec dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar në relacionin e paraqitur nga Drejtoria:

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI :**

- 1.Të miratojë nivelin e qerasë mesatare në tregun e lirë, sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec, sipas tabelës bashkangjitur.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ; Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhmit Financiar, Drejtoria Emergjencave, Strehimit, Pronësisë dhe Bashkëpronësisë, Administrimit të tokës dhe supervizimit të shërbimeve Bashkia Pogradec .



**Tabela.1**

Niveli mesatar i qerasë në tregun e lirë sipas strukturave të apartamenteve në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2025.

Nr	Emërtimi, tip i apartamentit	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar
1	Ap.Garsoniere	muaj	1	7,000 lek
2	Ap. 1+1	muaj	1	12,000 lek
3	Ap. 2+1	muaj	1	15,000 lek
4	Ap. 3+1	muaj	1	20,000 lek

3.Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

**KRYETARE E KËSHILLI**  
**Manjola KAMOLLI**



**1.Miratuar me** 22 **vota**

**2.Vota Pro** 22

**3.Vota Kundër** 0

**4.Vota Abstenim** 0

**5.Zbardhur më date** 25.02.2026